

sportelloscuola

“Progetto Scuole e culture del mondo



Një shërbim i menduar për familjet e huaja dhe italiane që rregistrojnë fëmijët e tyre në shkollat 8 vjecare të Parmës

Kush jemi

në sportelin e shkollës (sportelloscuola) bashkëpunojnë figura të ndryshme profesionale: një koordinues i projektit, një operator dhe 12 ndërmjetës gjuhësorë dhe kulturorë të po aq zonash gjeografike.

Cfarë bëjmë

Familjet italiane dhe të huaja nëpërmjet Sportelloscuola do të jenë në gjendje të kenë informacione në lidhje me:

- shkollën italiane dhe organizimin e sistemit shkollor 8 vjecar në Parma;
- mënyrat e regjistrimit në shkollë;
- Organet dhe Institucionet përgjegjëse për organizimin e shkollës (Zyra Provinciale Arsimit dhe Organet e tjera të territorit);
- Komuna e Parmës dhe shërbimet e saj për shkollën 8 vjecare (ndihmë financiare për të drejtën për të studiuar si përshembull kuponat për librat dhe subvencione të tjera, të transportit shkollor, ushqimit në mensë, etj ...);
- qendrat dhe shërbimet lokale për mbështetjen e shkollës;
- qendrat e informacionit dhe të orientimit (Informagiovani, etj...);
- Shoqatat e territorit dhe vendet e takimit (Qendrat për të rinjtë, etj ...);
- shërbimet verore dhe mënyrat e regjistrimit, marrja e kuponave që ofron Komuna e Parmës;
- kurset e italishtes L2 dhe L1;
- material informues, edhe dygjuhësh, për shkollat dhe familjet.

Familjet e huaja që sapo kanë bërë bashkimin familjar me fëmijen/të do të kenë një mbështetje konkrete gjatë momentit të regjistrimit në shkollë nepermjet kontributit të ndërmjetësve gjuhësorë dhe kulturorë për f utjen, ambientimin në shkollë dhe për një mikpritje të personalizuar.

Adresa: Rruga (Via) Milano, 14

Hapur: te Henen, te Merkuren nga ora 16 deri ne 18

Te Premten nga ora 10 deri ne 12 mundesisht me takim

Kontakt : Tel: 0521 784459 - mail: sportelloscuola@comune.parma.it